



**Republika e Kosovës**

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2019



**Komuna e Kaçanikut**

### **Procesverbal**

#### **Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019**

**Më 17.04.2019**

Në takim prezantuan:

**Ylber Bajra**, Nënkyrytarë i Komunës

**Halim Shehu**, Komandant i Policisë-Kaçanik

**Ali Vishi**, përfaqësues i FSK-së

**Kjani Sallahu**, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

**Fatmir Qaka**,EVSB

**Ramadush Osmani**-Drejtëor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

**Fadil Guri**-Zyrtarë për Komunitete dhe Kthim

**Menduh Rexha**-Bashkësia Islame

**Shemsedin Abazi**-(KLSP)

**Vedat Dema**-Zyra për Barazi Gjinore

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

Me arsyе mungoi Lirije Luta

Takimin e monitoruan nga MAPL- Labinot Sadiku dhe Arbër Beka nga Inspektorati i Policisë së Kosovës

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut **Z.Ylber Bajra** dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Vizitë në teren dhe verifikimi i shqetësimeve që cënojnë sigurinë publike
- 4.Të ndryshme

#### **1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar**

- Procesverbali u miratua nga të pranishmit

#### **2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut**

Nënkryetari i komunës uroi komandantin e ri të Stacionit të Policisë Halim Shehun të cilit i dëshiroi punë të mbarë në detyrën e re si dhe i dha fjalën për të na njoftuar rrëth gjendjes së sigurisë në komunën tonë.

**Komandanti i Policisë:**Uroj që bashkpunimi në mes të institucioneve të sigurisë në komunën e Kacanikut të vazhdojë edhe në të ardhmën.Në këtë detyrë kam filluar para disa ditëve dhe në bazë të informacioneve që kam gjendja e sigurisë në komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve në përgjithsi ka qenë e qetë.Në 24 orëshin e fundit kemi dy raste , një në fshatin Gajre ku si pasojë e një zënke në mes dy fëmijëve , një fëmijë ka pësuar lëndim të lehtë nga një therje me thikë dhe një rast tjetër dhunë në familje në fshatin Soponicë.Të dy rastet janë dërguar në procedurë të mëtutjeshme.Aksidente në trafik nuk kemi pasur dhe ne jemi të përkushtuar që me aktivitete të ndryshme të pengojmë edhe dukuritë tjera negative , siq janë përdorimi i narkotikëve nga të rinjët si dhe dukuria e vjedhjeve.

Kërkojmë një bashkpunim edhe më të madh me prokurorinë dhe inspektorët komunal në parandalimin e qdo dukurie që cënon sigurinë e qytetarëve.Gjithashtu brengosëse është edhe dukuria e shitjes së cigareve me copë nga disa markete për të rinjët adoleshent andaj kërkoj edhe nga inspektorët komunal që të bashkunojnë në kët drejtim që të parandalojmë kët dukuri.

**Nënkryetari:**Në lidhje me shitjen e cigareve për adoleshent kam pasur një takim me inspektorët komunal të cilët së bashku me policinë kanë dalur në teren dhe janë marrë me këtë problematikë.

**Komandanti i Policisë:**kohëve të fundit ka shqetësimë të qytetarëve në lidhje me prezencën e arinjëve në disa pjesë të territorit të komunës së Kaçanikut por deri më tanë nuk kemi informacione që këto arinjë kanë bërë ndonjë dëm.

### **3.Vizitë në teren dhe verifikimi i i shqetësimeve që cënojnë sigurinë publike**

Në kët pikë të rendit të ditës fjala iu dha Kjani Sallahut , anëtarë i komisionit përpilimin e planit të punës për kët vit që të na njoftoj se çka konkretisht kan menduar në lidhje me kët pikë të rendit të ditës

**Kjani Sallahu:**ideja ka qenë që të krijohet një grup i përbashkët me anëtarë të KKSBB-së dhe zyrtarë komunal dhe të dalin në teren me qëllim që të njihemi më mirë në lidhje me problemet që ballafaqohen qytetarët.Si probleme që mundë të na paraqiten janë mungesa e barrierave nëpër ato rrugë ku është e nevojshme të ket,mungesa e laurave pran hekurudhave dhe shum probleme tjera që ne mundë ti hasim gjat këtij aktiviteti.

**Nënkyetari:** çështjen e mungesës së laurave pran hekuradhave e kam ngritur në një takim me zyrtarët e hekurudhave ,e sa i përket idësë së Kjaniut pajtohem për krijimin e këtij grupei që të dilet në teren dhe të njihemi më për së afërmë me problemet që i preukupojnë qytetarët.

**Fadil Guri:** edhe unë pajtohem me kët ide dhe mendoj se duhet evidentuar rastet që janë më emergjente dhe të punohet në sanimin e këtyre rasteve.Në rrugën që lidhë fshatin Nikaj dhe Biçec është një problem i kahmotshëm që e kam cekur edhe në takimet e kaluara. Duhet që ky problem të zgjidhet nga institucionet komunale.Zyrtarët komunal kan dalë në kët vend dhe e kan parë gjendjen por që nuk kan dhënë kurrfar efekti.Të gjinden ata që e kan krijuar problemin dhe të japid përgjegjësi për dëmtimet që i kanë bërë në kët rrugë.

### **4. Të ndryshme**

**Nënkyetari :** Përpara i kam rekomandimet e nxjerrura nga viti i kaluar e në lidhje me këto rekomandime ne mundë të diskutojmë se çka është ndërmarrë në përmisim të gjendjes së sigurisë në komunën tonë duke i pasur parasyshë këto rekomandime.

**Ramadush Osmani:**sa u përket rekomandimeve të nxjerrura nga viti i kaluar ne si drejtori kemi bërë selektimin e tyre se qka kemi ndërmarrë në përmisimin e gjendjes së sigurisë e sidomos në kryerjen e shërbimeve komunale dhe emergjencë dhe mundë të themi se një pjesë e madhe e këtyre rekomandimeve janë realizuar dhe pjesën tjetër do të mundohemi në vazhdimsi ti realizojmë. Dukuri shqetësuese nga viti i kaluar ka qenë prezenca e zjarreve ku si pasojë kemi pasur djegie të stallave,plemeve dhe sipërfaqeve të pyllëzuara.Gjithashtu kemi pasur ankesa dhe kerkesa nga qytetarët në lidhje me shërbimet publike siq janë mbeturinat dhe uji dhe ne jemi munduar që të jemi në shërbim të tyre me ato kapacitete që kemi.Problematikë në vitin e kaluar kan qenë edhe vërshimet ku në disa vende përroskat kanë dalë nga shtrati i tyre dhe kan krijuar dëme në disa shtëpi

**Fadil Guri:**ka pasur shum zjarre të cilat nuk kan qenë të rastit por të qëllimshme.E kam përshtypjen se disa bujq nganjëher qëllimi isht kan djegur të mbjellurat e tyre me qëllim të mbulimit të dëmit nga institucioni.Kam një kërkesë që ne në takimet që i mbajmë të flasim,të

evidentojmë problemin, të mirremi me zgjidhjen e problemeve përndryshe nuk ja vlenë të takohemi kot.

**Zahir Doda:**kemi pasur takim me policinë të cilët jan marrë me një hulumtim rrëth dukurisë së drogave nëpër shkolla dhe nga ky hulumtim është nxjerrë se kjo dukuri është prezente por jo në atë masë sa thuhet.Bashkpunimin e kemi pasur shum të mirë me policinë ku kemi zhvilluar aktivitete të përbashkëta nëpër shkolla.Ndër aktivitetet që ka qenë është edhe aktiviteti me moton „Pa uniformë”, ku mundë të konstatojë se ka qenë projekt që ka pasur efekt.Këto që u thanë kan qenë edhe si problematika të cilat kanë hyrë në rekomandimet e vitit të kaluar me çrast janë mbajtur ligjerata për vetdijsim mbi dukuritë negative dhe komunikacionin.Vazhdimesh si shqetësim vitin e kaluar ka qenë mungesa e parkingjeve por që mendoj se me një marrëveshje sidomos në sezonin e verës kur nxënësit janë në pushim mundë të shfrytëzohen edhe hapsirat e oborreve të shkollave.

**Kjani Sallahu:**operimet e kompanisë Bechtelenka kanë prodhu dukuri negative sidomos në vjedhje dhe apeloj që kjo dukuri të marrë fund një herë e përgjithmonë pasi që edhe punimet janë në përfundim e sipër dhe uroj që kjo dukuri të mos përhapet në pista tjera.

Falënderoj drejtoret për raportet e tyre rrëth rekomandimeve por që sugjeroj që në të ardhmën të parashihet buxhet më i madh për raste emergjente.

**Komandanti i Policisë:**kemi raste kur kompani të ndryshme gjat kryerjes së punimeve afër rrugëve disa prej tyre përdorin shirita për bllokim të rrugëve e disa nuk e bëjnë kët veprim.Më intereson të dijë se a kërkojnë këto kompani leje nga komuna .

**Ramadush Osmani:**në këto raste kompanitë jan të detyruara që të kërkojnë leje në komunë dhe nëse këtë nuk e bëjnë atëherë mundë edhe të ju ndërpriten punimet.

**Kjani Sallahu:**në rrugën Nikaj- Biçec më parë kan qenë të vendosura shenjat e komunikacionit por më vonë nga persona të pandërgjegjshëm këto shenja janë dëmtuar.Është mirë që këto shenja prap të vendosen.

## **REKOMANDIMET:**

- 1.Kërkohet bashkëpunim edhe më i mirë i institucioneve të sigurisë
- 2.Të shfrytëzohen oborret e shkollave nëse paraqitet nevoja për parkingje në sezonin e verës.
- 3.Të mirren masa në parandalimin e përhapjes së së dukurisë së vjedhjes.
- 4.Të parashihet bugjet edhe më i madh për rastet emergjente
5. Të krijohet një grup i përbashkët nga anëtarët e KKSBB-së dhe Komunës për evidentimin e rasteve më urgjente për të intervenuar në teren
- 6.Të vendosen barrierat dhe shenjat e komunikacionit aty ku është e arsyeshme për tu vendosur.

Pas këtyre rekomandimeve Nënkyetari përmbylli takimin për tu takuar në mbledhjen e radhës

**Kaçanik 17.04.2019**

Kryesuesi:  
Nënkyetari i Komunës  
**z.Ylber Bajra**



Procesmbajtës:  
**Fatmir Qaka**